Procedurat, afatet dhe mënyrat e organizimit për çdo formë konsultimi

Forma e konsultimit	**Procedura e organizimit**	**Afati minimal**	**Mënyra e zhvillimit**
Konsultim publik me takime të hapura	Publikimi i njoftimit, shpërndarja e draft-aktit, organizimi i mbledhjes dhe administrimi i komenteve	Jo më pak se 20 ditë pune para miratimit	Takime publike në sallë ose në njësitë administrative
Dëgjesa publike	Hartimi i axhendës, njoftimi i palëve të interesit, mbajtja e procesverbalit	15–20 ditë pune	Dëgjesa me komunitetin, bizneset dhe grupet e interesit
Konsultim elektronik	Publikimi i draftit në faqen zyrtare dhe marrja e komenteve online	Minimumi 20 ditë kalendarike	Platforma online, email institucional, media sociale
Fokus-grupe tematike	Përzgjedhja e pjesëmarrësve sipas fushës dhe zhvillimi i diskutimit	Sipas natyrës së aktit	Takime tematike me ekspertë, OJF dhe komunitet
Pyetësorë dhe anketime	Hartimi i pyetësorit dhe shpërndarja në komunitet	10–15 ditë	Formularë fizikë ose elektronikë
Takime në terren	Njoftimi paraprak dhe organizimi në zonat përkatëse	Sipas planifikimit	Takime në lagje/fshatra me banorët
Konsultim me institucione dhe aktorë lokalë	Dërgimi zyrtar i draftit për mendim dhe mbledhja e komenteve	10–20 ditë	Korrespondencë zyrtare dhe tryeza konsultimi